



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PEJË**  
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

---

**P nr. 365/16**

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA THEMELORE NË PEJË D.P., gjyqtari Sejdi Blakaj me sekretaren juridike Gjyljeta Çorkadiu, në lëndën penale kundër të pandehurit, sipas aktakuzës së PTH-së D.P. në Pejë PP/II. nr.532/16 të dt.22.4.2016 për shkak të veprës penale: të sulmit nga neni 187 par 1 të KPRK-së, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar, publik dhe me gojë, të mbajtur në praninë e të pandehurit dhe të prokurorit të shtetit Esad Muharemi, me dt.15.3.2017 ka marrë dhe botërisht ka shpallë këtë :

**AKTGJYKIM**

**I pandehuri Xh. K. i lindur me dt, i biri i Sh. dhe nënës F. e gjinisë S., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës kinse i pa dënuar.**

**ËSHTË FAJTOR**

Për arsye se:

Me dt. 17.2.2016, rreth orës 14:30 minuta, në Pejë në rrugën E.H, me dashje përdorë forcën ndaj të dëmtuarit, në atë mënyrë që përderisa i dëmtuari ishte duke qarkulluar me veturën e tij, ndalohej nga këtu i pandehuri i cili e pyet duke ju drejtuar me fjalët “ a fole me babën tënd për qat tokë” ashtu që pasi i dëmtuari i përgjigjet me fjalët “bonja qysh dush”, i pandehuri e godet me flakaresh në gojë, me ç’ rast i dëmtuari Milor largohet nga vendi i ngjarjes, ndërsa më pas lajmëro rastin në polici.

-me çka ka kryer veprë penale : të sulmit nga neni 187 par 1 të KPRK-së

Prandaj gjykata të pandehurin konform nenit 41, 42,43,46 dhe nenit 187 par 1 të KPRK-së e.

**GJYKON :**

Me dënim me gjobë në lartësi prej 200 euro, e të cilën gjobë i pandehuri është i obliguar që ta paguaj brenda 3 muajsh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë .

Nëse i pandehuri gjobën në fjalë nuk e paguan brenda këtij afati – dënimi me gjobë automatikisht do të shëndohet në dënim me burg – duke llogaritur 20 euro = 1 ditë burg !.

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 15 euro – 15 ditë pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë .

I dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil

Shpenzime procedurale nuk ka pasur .

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë me dt.22.4.2016 kundër të pandehurit Xh.K., ka ngritë aktakuzë PP/II. nr.532/16 për shkak të veprës penale: të sulmit nga neni 187 par 1të KPRK-së duke i propozuar gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë të pandehurin ta shpallë fajtorë, ta dënoj sipas ligjit dhe ta obligoj në pagimin e shpenzimeve procedurale .

Në shqyrtimin fillestarë i pandehuri – pasi që paraprakisht i është lexuar aktakuza , është njoftuar me të drejtat dhe detyrimet procedurale dhe pasojat e pranimi përkatësisht të mos pranimi të fajësisë- e ka pranuar fajësinë dhe ka manifestuar keqardhje për atë që i ka ndodhur. Këtë pranim fajësie gjyqtari – pasi që paraprakisht e ka marrë pëlqimin e prokurorit shtetit i bindur se pranim fajësinë i pandehuri e ka bërë ashtu siç e parasheh ligji – vullnetarisht dhe pa u ndikuar nga askush dhe në asnjë mënyrë e ka pranuar .

Meqenëse i pandehuri e pranoj fajësinë gjyqtari kaloj në marrjen e vendimit lidhur me llojin dhe lartësinë e masës ndëshkuese, me ç rast i pati parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Rrethanë rënduese në rastin konkret gjyqtari nuk ka gjetur , kurse nga ato lehtësuese ka çmuar : pranimin e singertë të fajësisë , pendimin e thellë për këtë gjë, qëndrimin korrekt në gjykatë, dhe kësisoj gjyqtari mendon se edhe me një vendim si në dispozitivin e aktgjykimit ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me neni 41 të KPK-së .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 të KPPRK-së

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarve në kontestin e rregullt civil është marrë konform nenit 463 të KPPRK-së .

Nga sa u tha më lartë konform nenit 365 të KPPRK-së u vendos si më lartë

Nga Gjykata Themelore në Pejë D.P. datë. 15.3.2017.

Sekretarja juridike  
Gjyljeta Çorkadiu

Gjyqtari  
Sejdi Blakaj

### **KËSHILLA JURIDIKE**

Kundër këtij aktgjykimi lejohet  
Ankesa në afat prej 15 ditësh nga  
Dita e marrjes , Gjykatës të Apelit në Prishtinë  
E përmes kësaj Gjykate .